

# Nevoja për një Strategji të Re Decentralizimi krahas Riorganizimit Administrativ dhe Territorial



PROPOZIMI SHTETIWEB

7 Mars 2014

## Objektivi sipas Programit të Qeverisë:

*“Qeveria do ta vërë në zbatim ndarjen e re administrativo-territoriale të vendit në prag të zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe do ta shoqërojë atë me një paketë reformash fiskale dhe ligjesh mbështetëse, si dhe me ngritjen e mekanizmave konkrete për fuqizimin e njësive të reja vendore”*

Pra, Reforma nuk do të jetë thjesht një riorganizim territorial i NJQV, por do të synojë **reformimin në tërësi** të qeverisjes vendore

# Reformë territoriale dhe/apo Reformë decentralizuese

Ekzistojnë dy mundësi:

1. Të bëhet vetëm riorganizimi i territorit, pa ndryshuar strukturën, funksionet dhe kompetencat e pushtetit vendor.
2. Të bëhet riorganizimi i ndarjeve administrative territoriale duke reformuar strukturën, funksionet, kompetencat dhe financat e pushtetit vendor.

Propozimi ShtetiWeb mbështet mundësinë e dytë.

# Pse duhet një Reformë tërësore?


- ✓ Prej vitit 2000 qeverisja vendore ende nuk është e aftë të ofrojë shërbimet e kërkuara nga banorët.
- ✓ Në gati 15 vjet transferimi i funksioneve, pronave, i financave drejt QV është i papërfunduar.
- ✓ Në një hartë administrative-territoriale tepër të fragmentarizuar me 385 njësi të qeverisjes vendore, decentralizimi mbetet më shumë një objektiv se sa një realitet.

# Dekoncentrimi zëvendëson decentralizimin

- ✓ Sipas ligjit, QV ka 21 funksione të veta, funksionet e përbashkëta janë vetëm 6.
- ✓ Në qëndër qarku funksionojnë rreth 35 drejtori, zyra dhe inspektoriate.
- ✓ Në shkallë vendi funksionojnë rreth 1000 njësi të pushtetit qëndror të dekoncentruar, gati dy herë më tepër se strukturat e QV.
- ✓ Disproporcioni i financave për shërbimet publike midis QV dhe QQ është i skajshëm: 7% kundrejt 93%.


# Shpenzimet e NJQV: vetëm 2% të PBB (Burimi: USAID)

## Shpenzimet e NJQV si % PBB-së dhe shpenzimeve publike




# 93% e shpenzimeve publike nga qeverisja qëndrore (Burimi: USAID)

Shpenzimet nën-kombetare të sektorit publik 2009



# Fragmentimi i NJQV i lartë, po jo i skajshëm





# Po burimet njerëzore?

- ✓ Numri i këshilltarëve të zgjedhur 6500.  
Personeli i administratës vendore 9320  
(pa personelin e shërbimeve)
- ✓ Administratat vendore po kthehen në  
struktura partiake nëpërmjet të cilave  
partitë realizojnë edhe funksionimin e  
tyre.
- ✓ Një numër i madh i personelit nuk  
plotëson kriteret minimale për të qënë  
nëpunës i shtetit.

# Çfarë Reforme nevojitet?

- ✓ Duhet një Reformë tërësore e qeverisjes vendore.
- ✓ Riorganizimi i territorit nuk mund të plotësojë objektivat e kërkuara nëse nuk shoqërohet me Reformën e Decentralizimit, dmth nëse nuk u jepen përgjegjësitë e plota dhe burimet e duhura financiare.
- ✓ *Nga duhet filluar? Ky nuk duhet të jetë një debat bllokues. Duhet një proces i programuar.*

# Reforma e Decentralizimit

- ✓ Reforma e Decentralizimit duhet të bazohet në Strategjinë dhe në Programin e Veprimeve.
- ✓ Për drejtimin dhe zbatimin e kësaj Reforme sugjerohet rikrijimi i Komitetit të Decentralizimit (ekzekutiv) dhe krijimi i një Komisioni parlamentar monitorues.
- ✓ Strategjia e Decentralizimit duhet të shoqërohet me paketën ligjore. Sipas vlerësimeve tona paraprake paketa përfshin rreth 20 ligje.

# Strategji e Re Decentralizimi

- ✓ Strategjia e Decentralizimit nuk mund të jetë vazhdim apo përditësim i asaj ekzistuese.
- ✓ Parimisht nevojitet një **Strategji e Re** në harmoni me Riorganizimin territorial, që do të ulë ndjeshëm numrin e NjQV.
- ✓ Riorganizimi territorial duhet të krijojë të gjitha premisat për një avancim më të shpejtë dhe të sigurtë të procesit të decentralizimit.

# Transferimi i funksioneve dhe përgjegjësiive nga QQ në QV

Strategjia duhet të synojë:

- Për funksionet e veta QV duhet ti transferohen të gjitha përgjegjësitë dhe buxheti i duhur.
- Funksionet e përbashkëta (6), që sot kryhen kryesisht nga QQ, të transferohen në *kryesisht të QV*, së bashku me buxhetin përkatës.
- E njëjta gjë edhe për funksionet e deleguara.

Këto transferime duhet të ulin numrin e Drejtorive dhe Zyrave të QQ të dekoncetruara.

# Shërbimet e reja të QV

Shërbimet e mëposhtme duhet të kryhen kryesisht nga NjQV, përgjegjësitë e kontrollit të tyre mund të mbahen nga QQ:


1. Arsimi para-universitar
2. Kujdesi shëndetësor parësor
3. Kujdesi social
4. Bujqësia dhe shërbimi veteriner
5. Mjedisi
6. Planifikimi i territorit

# Decentralizimi Fiskal

- ✓ Decentralizimi fiskal duhet të rishikohet në funksion të ndarjes së re territoriale dhe administrative.
- ✓ Dy janë burimet kryesore të të ardhurave vendore: të ardhurat e veta dhe transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara nga QQ.
- ✓ Vitet e fundit shihet një prirje e uljes së të ardhurave të veta dhe të transfertave qeveritare.
- ✓ “Të ardhurat e veta” nuk janë ato që mblidhen nga QV, por ato që përdoren nga QV.

# Të ardhurat e veta në 5 vitet e fundit:

## Raporti i te ardhurave te veta ndaj totalit te te ardhurave, ne %



Të ardhurat vendore nuk janë në përpjesëtim me funksionet e veta dhe të përbashkëta të organeve vendore.



# Rritja e të ardhurave të veta:

- ✓ Taksa e pronës duhet të jetë burim kryesor për QV. Aktualisht kjo taksë përbën 20% të ardhurave QV. Duhet kaluar në sistemin e llogaritjes së taksës sipas vlerës së pronës në treg.
- ✓ Duhet të futet gradualisht ndarja e taksave të përbashkëta, si tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatim fitimi.
- ✓ Me ligj duhet të caktohet që nga të ardhurat e rentave të burimeve natyrore (minierat, hidrokarburet, ujrat) 20-30% të kalojnë për qeverisjen vendore.
- ✓ Duhet të formatohen databaza për çdo taksë vendore, për të bërë të mundur përcaktimin e potencialit të burimeve financiare të NjQV.

# Sa më e madhe NjQV aq më e mirë performanca fiskale dhe financiare

- ✓ NjQV me mbi 10 mijë banorë, kanë 3.5 herë më shumë të ardhura/banor ( 2.500 lekë të ardhura/banor),
- ✓ NjQV me më pak se 10 mijë banorë, vetëm 700 lekë/banor. Aktualisht janë afro 300 NjQV me më pak se 10 mijë banorë. Akoma më i madh është ky raport në njësitë të cilat kanë mbi 20 mijë banorë.
- ✓ Pra, rritja e NjQV do të ketë ndikim pozitiv në performancën fiskale të qeverisjes vendore.

# Transfertat qeveritare

Granti i pakushtëzuar ra nga:

14,859,000 lekë në vitin 2009

11,215,700 lekë në vitin 2010

11,113,200 lekë në vitin 2011.

Rënia e grantit të kushtëzuar ishte edhe më dramatike:

5,500,000 lekë në vitin 2009

2,867,000 lekë në vitin 2010

2,900,000 lekë në vitin 2011

# Transfertat qeveritare

- ✓ Formula e transfertave të pakushtëzuara duhet të ndryshohet në harmoni me riorganizimin territorial dhe të bazohet në kostot e shërbimeve të standartizuara.
- ✓ Fondi duhet të përcaktohet në ligj si një % ndaj buxhetit kombëtar, ose ndaj PBB.
- ✓ Sugjerohet që të ardhurat vendore të arrijnë në 9-10% të PBB-së dhe në 35% të shpenzimeve publike deri në 2017.

# Grantet konkurruese

- ✓ Vendosja e kriterëve të qarta dhe të matshme për shpërndarjen e granteve konkurruese për rajonet dhe një proces të hapur për vendimmarrjen për këto grante.
- ✓ Ngritja e Fondeve të Zhvillimit sipas Rajoneve.
- ✓ Vendosja e një sistemi të ri për menaxhimin e projekteve të zhvillimit rajonal, bazuar në parimet e efikasitetit, transparencës dhe uljen e pabarazive social – ekonomike të territorit.

# Nga duhet të fillojë Reforma AT?

Nga përcaktimi i strukturës së qeverisjes vendore:

Sipas Shtetiweb QV duhet të vazhdojë të jetë e organizuar në dy nivele:

- ✓ Niveli i I: Bashkitë, fokusohet kryesisht në shërbimet ndaj banorëve,
- ✓ Niveli i II: Rajonet, fokusohet kryesisht në zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

Ka mendime që QV të jetë me një nivel.

# Bashkitë

- ✓ Reforma duhet të bëj shkrirjen e komunave dhe bashkive të vogla në njësi më të mëdha dhe me më shumë kompetenca, burime financiare dhe njerëzore, që të kryejnë shërbimet ndaj banorëve.
- ✓ Bashkitë e krijuara do të jenë:
  - *kryesisht urbane*, (qytetet kryesore bashkohen me territore në proces urbanizimi të komunave përreth),
  - *të përzjera urbane dhe rurale* (qytete të vogla bashkohen me komuna me identite të përafërta),
  - *tërësisht rurale*, (bashkimi i disa komunave), këto të kufizuara kur plotësohen kriteret e më sipërme.

# Rajonet

- ✓ Rajonet do të organizohen kryesisht sipas baseneve kryesore ujore të vendit dhe resurseve të tjera natyrore, për të siguruar me prioritet zhvillimin ekonomik të territoreve të tyre.
- ✓ Rajonet duhet të strukturohen për të siguruar fondet strukturore dhe të kohezionit të BE-së dhe për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga programet e IPA-s, dhe iniciativa të tjera të destinuara për Ballkanin Perëndimor.



# Rajonet

Krijimi i Rajoneve do t'u japë një drejtim të ri:

- ✓ hartimit dhe zbatimit të strategjive rajonale të zhvillimit;
- ✓ do t'i hapë rrugë zgjerimit kompetencave të institucioneve dhe agjencive në nivel rajonal;
- ✓ do të sjellë rritjen e burimeve financiare dhe asetëve për rajonet;
- ✓ do të krijojë një model të ri dhe më efikas organizimi dhe funksionimi të autoriteteve qendrore dhe vendore në nivel rajonal.

# Ligji mbi Zhvillimin Rajonal

- ✓ Ligji mbi Zhvillimin Rajonal do të rregullojë synimet, parimet dhe procedurat në lidhje me menaxhimin e zhvillimit rajonal. Ligji do të përcaktojë strukturat konsultative dhe zbatuese në nivel kombëtar dhe rajonal.
- ✓ *Këshilli Kombëtar i Partneritetit për Zhvillimin Rajonal*, do të mbledhë së bashkë qeverinë qendrore, qeverisjet rajonale dhe vendore, partnerët socialë dhe shoqëri civile
- ✓ *Këshillat e Partneritetit të Rajoneve*, që do të mbledhin së bashku të njëjtët aktorë – por në nivel rajonal.

# Propozimi ShtetiWeb: 5 Rajone

1. Rajoni i Shkodrës (Shkodër, Lezhë, Kukës)
2. Rajoni i Arbrit (Dibër, Tiranë, Durrës)
3. Rajoni i Muzakajve (Fier, Berat)
4. Rajoni Elbasan – Korçë (Elbasan, Korçë)
5. Rajoni Kaonve (Vlorë – Gjirokastër)

Tirana – Kryeqyteti – Status i Veçantë

# Nr.mesatar i banorëve për Bashki sipas Qarqeve

1. Shkodra	42800	Lezha*	34300	Kukesi	34600
2. Dibra	34650	Tirana*	49000	Durresi	58700
3. Elbasani	48500	Korca	40800		
4. Fieri	44200	Berati	36000		
5. Vlora	34000	Gjirokastra	24000		

- **Mesatare shkallë vendi 47000 banorë**